



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PËRSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 19877 Prot.,

Lezhë, më 17. 11 .2025

URDHËR

Nr. 626 Datë 17. 11 .2025

**PËR KALIMIN NË GADISHMËRI TË GRUPIT TË PUNËS PËR MENAXHIMIN E
SITUATËS EMERGJENTE PËR SHKAK TË RESHJEVE TË SHIUT**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, nenit 9 pika 1.1 gërma "b" të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 88, nenit 89, neni 90 dhe neni 91 ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM-së nr. 568 datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, orët shtesë dhe kompensimin të tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e varura dhe njësitë e vetqeverisjes vendore", nenit 14, VKM-së Nr. 923, datë 25.11.2020 "Për Funkionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile", të ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" si dhe shkresës Nr. 17417 Prot, Datë 07.10.2025 të Drejtorisë së Emergjencave Civile, me lëndë: "Plan Masash"

URDHËROJ:

1. Për shkak të situatës së paralajmëruar nga Instituti i Gjeoshkencave për reshjet që do jenë prezente në datat 17 deri me 19 Nëntor, për rrjedhojë urdhërohen Drejtoritë dhe Njësitë Administrative të poshtëshënuara që të jenë në gadishmëri për të menaxhuar situatën e parashikuar për reshjet e shiut.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen:
 1. Drejtoria e Emergjencave Civile
 2. Policia Bashkiake
 3. Drejtoria e shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit
 4. Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve
 5. Njësia Administrative Shëngjin

6. Njësia Administrative Shënkoll
 7. Njësia Administrative Zejmen
 8. Njësia Administrative Kolsh
 9. Njësia Administrative Balldren
 10. Njësia Administrative Blinisht
 11. Njësia Administrative Dajç
 12. Njësia Administrative Kallmet
 13. Njësia Administrative Ungrej
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Brikena Vuksani

